



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -*  
*Ministry of Finance, Labour and Transfers*



*Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs*

---

**11.02.2025**

**Njoftim për Komunitetin e Biznesit në Kosovë**

**Lënda: Informacion mbi Sistemin e Kontrollit të Importit 2 (ICS2) të BE-së**

Të nderuar/a,

Ju informojmë se Dogana e Kosovës ka pranuar një njoftim nga BE- DG TAXUD në lidhje me zbatimin e Sistemit të Kontrollit të Importit 2 (ICS2), ku të gjitha mallrat e transportuara përmes rrugëve detare, tokësore dhe hekurudhorë, drejt ose përmes BE-se duke përfshirë dërgesat postare dhe ato të shpejta do ti nënshtrohen kërkesave të reja ligjore. Ky sistem i ri do të kërkojë të dhëna paraprake për sigurinë dhe mbrojtjen për mallrat që dërgohen në BE ose përmes BE-së, **duke filluar nga 1 Prilli 2025**. Kjo do të bëhet nëpërmjet një Deklarate Përmbledhëse të Plotë të Hyrjes (ENS). Operatorët Ekonomik duhet të dërgojnë të dhëna sigurie në SKI2 përmes një deklarate përmbledhëse hyrëse dhe do të duhet të lidhen me një sistem të IT-se për dërgimin e këtyre të dhënave. Operatorët ekonomik duhet të regjistrohen në sistemet e vendeve anëtare të BE-se dhe të marrin numrin e tyre regjistruar.

Operatorët Ekonomik Kosovar duhet regjistrohen sa më shpejtë, sepse pas datës 1 Prill 2025 nuk do të mundën të eksportojnë apo tranzitojnë mallra për në vendet anëtare të BE-së, pa qenë i regjistruar dhe pa ofruar të dhënat paraprake që kërkohen.

Sipas njoftimit në shkresën e dërguar nga DG TAXUD, Komisioni Evropian organizon seminare mujore në internet (në anglisht) ku operatorët ekonomikë mund të bëjnë pyetje rreth aspekteve

operacionale dhe teknike të ICS2. Komisioni mund të organizojë seminare specifike në javët në vijim për vendin ose rajonin me kërkesë të vendeve. Ne si Doganë e Kosovës kur të pranojmë njoftimin rreth këtyre seminareve online nga BE do të ju njoftojmë të gjithë juve përfshirë odat ekonomike dhe shoqatat e bizneseve, me qëllim të përcjelljes së njoftimit tek te gjithë bizneset që të marrin pjesë dhe të njoftohen më hollësisht me procedurat e reja që kërkohen nga BE-ja.

Ne besojmë se në ditët në vijim edhe Zyra e BE-së në Kosovë do të ndaj informata më të hollësishme për komunitetin e biznesit në Kosovë , por marr parasysh afatet e hyrjes në fuqi janë afër, ne si Doganë e Kosovës e konsideruam të rëndësishme që të ndajmë këto informata që i kemi pranuar sa më pare me komunitetin e biznesit në Kosovë dhe me qëllim që bizneset kosovare të marrin veprimet sa më shpejtë, dhe veprimet e tyre të jenë në harmoni me kërkesat e BE-së.

Ju lutemi të shpërndani këtë informacion me të gjitha bizneset kosovare lidhur dhe njoftimin që kemi pranuar nga DG TAXUD. Për më tepër, bizneset mund të qasen ueb faqen zyrtare ( *shiko linkun në shkresën nga DG TAXUD*) dhe të njoftohen më hollësisht me kërkesat që duhet plotësuar.

Dogana e Kosovës do të jetë në dispozicion dhe do të ofroj dhe ndaj çdo informacion që pranon, mirëpo këto janë rregulla të BE-se , prandaj besojmë se zyra e BE-së në Kosovë do të njofton më hollësisht bizneset Kosovare dhe do të ofron ndihmën e nevojshme për procedurat e reja që kërkohen në vendet e BE-së nga data 1 Prill 2025.

Me respekt,

Dogana e Kosovës